



Vjollca Salihu është profesioniste e lartë në fushën e së Drejtës dhe administratës publike, me një përvojë të pasur mbi dy dekada në institucione publike, akademike dhe private në Kosovë. Ajo mban titullin Doktor në Shkenca Juridike në profilin e së Drejtës së Biznesit, dhe ka përfunduar studimet Master në Menaxhimin e Resurseve Njerëzore si dhe studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Karriera e saj akademike përfshin përvojë të gjerë si ligjëruese dhe asistente në lëndët juridike në universitete të ndryshme në Kosovë, përfshirë Universitetin Publik të Gjilanit (UPGJ), Universitetin Publik të Prizrenit (UPZ) dhe Kolegjin Victory, Për më shumë se një dekadë, ajo ka qenë pjesë kyçe në strukturat drejtuese të arsimit të lartë si sekretare universitare, duke mbikëqyrur menaxhimin administrativ, përpilimin e akteve normative, marrëdhëniet me MASHT dhe Agjencinë e Akreditimit, si dhe proceset e kontraktimit të stafit akademik

dhe studentëve. Ajo është autore e disa punimeve shkencore të botuara dhe të indeksuara në revista prestigjioze ndërkombëtare (Scopus), si dhe pjesëmarrëse aktive në konferenca ndërkombëtare. Ka përfunduar trajnime të shumta në fusha të menaxhimit publik, leadershipit, dhe përafrimit të legjislacionit me BE-në. Aktualisht, znj.Salihu ushtron dy pozita të rëndësishme në nivel shtetëror dhe institucional: Drejtoreshë e Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës – Trainkos Sh.A" dhe Udhëheqëse e Njesisë për Administrimin dhe Sistemin e Dokumenteve në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Në këto role, ajo kontribuon në vendimmarrje strategjike, përmirësimin e efikasitetit administrativ dhe rritjen e transparencës institucionale.

Kontakti:

✉ vjollca.salihu@trainkos.com

☎ 038/534-821